



Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	21. 09 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSJICK	5577/2022		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.692/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.692/2022 të datës 08.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë në Komunë të Fushë Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1221/2022 të datës 03.08.2022 të Ministrisë së Punëve të Brendshme-Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.692/2022 e datës 08.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.1221/2022 i datës 03.08.2022 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Racionalizimin e Proceseve Administrative", sipas Akt Emërimit të datës 23.08.2016 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Obligohet Sekretari i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Racionalizim të Proceseve Administrative" sipas Akt Emërimit të datës 23.08.2016 i cili institucion funksionon si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 03.08.2022 përmes vendimit me numër 1221 të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm-Njësia e Burimeve Njerëzore është bërë transferimi i përkohshëm i të njëjtit nga pozita "Drejtor i Drejtoratit për Racionalizimin e Proceseve në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit" në pozitën "Drejtor i Drejtoratit të Trajnimit në Institutin e Kosovës për Administratë Publike- IKAP- Ministria e Punëve të Brendshme" me arsyetim se transferimi bëhet në interes të Institucionit respektivisht në interes të Institutit të Kosovës për Administratë Publike, ndërsa në piken dy (2) të vendimit është caktuar edhe kohëzgjatja e transferimit nga data 04.08.2022 deri me datën 03.02.2023, ndërsa sipas pikës 3 të të njëjtit vendim paga mbetet e njëjtë.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me Vendimin Nr.1221/2022 të datës 03.08.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me transferin përkohshëm me datë 08.08.2022-numër protokoll 4595 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi në fjalë është vendim arbitrar (i pa ligjshëm) me të cilin cenohen-shkelen direkt të drejtat e njeriut të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht "Kapitulli II ku flitet për të Drejtat dhe Lirit Themelore, Konventat ndërkombëtare, legjislacioni që rregullon marrëdhënien e punës dhe se me rastin e ankesës i është referuar dispozitave të Ligjit të Zyrtarëve Publik nr.06/L-114, Rregullores nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Ligjit nr.04/L-145 për Organet e Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe duke specifikuar hollësisht dispozitat ligjore të lartshënuara, dhe me këtë rast i ka propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës që ta aprovoj ankesën e ankuesit në tërësi si të bazuar dhe ta anuloj vendimin me Nr.1221/2022 të datës 03.08.2022 për transferim të përkohshëm si dhe të merren me masa ndaj personave përgjegjës që kanë nxjerrë një akt të tillë të paligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.08.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli, më datë 26.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës 1/8.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.08.2022 me numër protokoll 4595/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emalin e datës 08.08.2022 lidhur me parashtrimin e ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 04.08.2022 të H.Sadiku drejtuar [redacted] Emalin e datës

05.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Vendimin me Nr.ref.1221/2022 të datës 03.08.2022 të Burimeve Njerëzore-MPB lidhur me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil; Akt emërimit me Nr.62 të datës 23.08.2016; Emailin e datës 11.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emailin e datës 10.08.2022 të KPMSHCK-së drejtuar [redacted] Emailin e datës 10.08.2022 të [redacted] drejtuar KPMSHCK-se; Emailin e datës 10.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emailin e datës 08.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emailin e datës 08.08.2022 të KPMSHCK-se drejtuar [redacted] Emailin e datës 08.08.2022 të [redacted] drejtuar KPMSHCK-së; Emailin datës 10.08.2022 nga [redacted] drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4640/2022 të datës 10.08.2022; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 4988/2022 të datës 26.08.2022; Shkresën lidhur me përgjigjen në ankesë të dorëzuar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Akt emërimit me Nr.62 të datës 23.08.2016; Emailin e datës 02.09.2022 me numër të protokollit 5120/2022 të [redacted] drejtuar KPMSHCK-së; Emailin e datës 02.09.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emailin e datës 16.08.2022 drejtuar [redacted]; Emailin e datës 16.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emailin e datës 15.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emailin e datës 15.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emaili, datë 01/09/2021, nga [redacted] drejtuar KPMSHCK-së; Emaili i datës 11/08/2022-përgjigje nga KPMSHCK për [redacted] dhe [redacted] Email, datë 19/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] Email, datë 19/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] Email, datë 18/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] Email, datë 18/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] Email, datë 16/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] Email, datë 16/08/2022, nga [redacted] drejtuar [redacted] përfundim sa i përket emailave janë të përfshirë nga faqja 9 deri në faqen 24, të provave që janë dorëzuar nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar sepse:

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që vendimi Nr.1221/2022 i datës 03.08.2022 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për transferim të përkohshëm është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë sepse nuk ka bazë ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil gjegjësisht sipas nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: *"Nëpunësi Civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit .Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar"*, si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se me rastin e nxjerrjes së vendimit për transfer në një lokacion tjetër përkundër që është brenda të njëjtës Ministri paraprakisht institucioni ku kërkohet të transferohet përkohësisht përveç që duhet të ketë një kërkesë të hollësishme për nevojën e institucionit duhet të marrë pëlqimin edhe të institucionit ku nëpunësi civil është duke punuar, kjo nga fakti se kemi të bëjmë me çështje të interesit të institucionit dhe ky interes duhet të argumentohet sipas kërkesës së institucionit ku do të transferohet nëpunësi dhe pëlqimin nga eprori kompetentë i vendit të punës ku punon nëpunësi aktualisht sepse vetëm këto dy elemente kërkesa dhe pëlqimi argumentojnë faktin se mund të bëhet fjalë për interes të institucionit me rastin e transferimit të përkohshëm dhe kjo formë nënkupton plotësimin e

kushteve që një nëpunës të transferohet përkohësisht duke eliminuar mundësin që në ndonjë formë të ketë ndonjë elementë të tendencës së caktuar ndaj ndonjë nëpunësi civil me rastin e transferimit të përkohshëm si dhe të mos ketë dilema se me rastin e transferimit të përkohshëm përkundër që mund të jetë interes i institucionit të caktuar transferi por në të njëjtën kohë nëse mungon edhe pëlqimi nga institucioni ku punon ankuesi atëherë mund të ndodhë që të dëmtohet apo cenohet interesi i institucionit tjetër si rezultat i moskordinimit të veprimeve të dy institucioneve që ndërlidhen me transferin e përkohshëm, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ndërlidhur me çështjen e potencuar si më lartë sa i përket kërkesës së institucionit ku kërkohet të transferohet si dhe pëlqimit të institucionit ku ka qenë duke punuar nëpunësi ,nga shkresat e lëndës vëren se përkundër që ankuesi në këtë rast ishte në pushim vjetor në këtë kohë të nxjerrjes së vendimit që është një e drejtë ligjore e nëpunësit, poashtu sipas shkresës/emailit të datës 04/08/2022 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së konfirmohet fakti se ky transferim është bërë pa pëlqimin e tij nga se ankuesi është vartës i tij dhe se përmes kësaj forme mund të pengohet funksionimi i disa shërbimeve brenda këtij institucioni nga se ankuesi është bartës i disa proceseve administrative, që rrjedhimisht i bie që përmes këtij transferi të përkohshëm cenohet qëllimi bazë i këtij instituti të përkohshëm mbi të cilin transferohet nëpunësi civil sepse nuk mund të ketë interes të institucionit përmes kësaj forme të transferit të përkohshëm përderisa konfirmohet se në vendin aktual të punës mbesin pezull disa përgjegjësi që lidhen me obligimet zyrtare të nëpunësit civil që transferohet diku tjetër, pra kolegji konstaton se interesi i institucionit duhet të jetë prioritet me rastin e këtij lloji të transferit e që nënkupton se nuk ka interes të institucionit përderisa nuk janë të harmonizuar veprimet ndërinstytucionale dhe pa ndonjë analizë të hollësishme në rastet kur kërkohen të bëhen transferet e përkohshme, andaj edhe në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet që: *"1.1.Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit,deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve"* dhe paragrafin 2,nënparagrafin 2.1 ku përcaktohet që:*"2.Transferimi mund të bëhet: 2.1.brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale"* dhe mbi këtë bazë ligjore konstatohet se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin ta transferoj përkohësisht për interes të institucionit ,mirëpo duke respektuar dispozitat e nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligj nga e cila dispozitë derivon Rregullorja (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ,e cila në nenin 5 paragrafi 2 ka përcaktuar se: *"Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet'*, andaj duke marrë për bazë këto referenca ligjore me rastin e transferimit ka konstatuar se Vendimi me Nr.1221/2022 i datës 03.08.2022 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes te cilit ankuesi është transferuar përkohësisht, ne interes te institucionit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që përveç se në preambulë ku është përshkruar neni 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2

nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë, me asnjë formë nuk është arsyetuar vendimi me qëllim që të arsyetohet në mënyrë të hollësishme interesi i institucionit në këtë rast ashtu si parashihet në nenin 5 paragrafi 2 të rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë e cila decidivishte parashih një analizë të hollësishme me rastin e nxjerrjes së vendimit për transferim që nënkupton se njësia përgjegjëse është e obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marr parasysh të gjitha specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunësit që transferohet respektivisht ne rastin konkret me rastin e transferimit të ankuesit ka qenë obligim që plotësimin e këtyre kushteve ta pasqyroj në arsyetim të vendimit të transferit, që të merr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankuesit në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku është transferuar nëpunësi e që në këtë aspekt në mungesë të një analize të hollësishme vendimi përkatësisht akti administrativë i kontestuar nuk i plotëson kriteret me qëllim që i njëjti të jetë i kuptueshëm dhe i qartë për ankuesin nga se një akt administrativë duhet të jetë në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 i cili shprehimisht parashih *"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1 paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;1.2 shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3 shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4 bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;1.5 shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6 në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim; 2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, në këtë kuptim Vendimi me Nr.1221/2022 i datës 03.08.2022 i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së, nuk është i bazuar në kuptim të dispozitave të nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj në këtë aspekt edhe nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Nr.06/L-113 përkatësisht nenin 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 ku specifikisht *parashihet"1. Drejtori ekzekutiv drejton dhe përfaqëson Agjencinë dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës për : 1.2 menaxhimin e burimeve njerëzore të Agjencisë në pajtim me ligjin për zyrтарët publikë"*poashtu bazuar në pretendimin ankimor analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit përkatësisht Nenin 5 ku parashihet Themelimi i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit ku në paragrafin 1 dhe 2 parashihet;*"1.Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (në tekstin e mëtejme: Agjencia) themelohet si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, apo në organin e lartë pasuese të administratës shtetërore që vendos Qeveria. 2. Agjencia është organ qendror i administratës shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, për institucionet e Republikës së Kosovës"*,poashtu ndërlidhur me këto dispozita analizoi edhe nenin 7 paragrafin 1 dhe 2 nënparagrafin 2.3 ku parashihet:*" 1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet në pajtim me rregullat dhe procedurat për emërimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës"* dhe *"2. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë është përgjegjës për: 2.3. menaxhimin efikas të burimeve njerëzore dhe financiare me të cilat disponon Agjencia"* dhe në këtë kuptim vendimi për transfer të përkohshëm të ankuesit bie ndesh me dispozitat e potencuara më lartë nga fakti se nuk kemi pasur koordinim dhe pëlqim të Drejtorit

ekzekutiv në lidhje me këtë transfer të ankuesit pasi sipas këtij ligji drejtori është përgjegjës për menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, ndërsa kjo rrethanë është e konfirmuar edhe nga shkresat e lëndës andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave poashtu analizoi dispozitat e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Nr.06/L-113 në lidhje me këtë çështje që është objekt i kësaj ankese dhe duke marrë për bazë faktin se pozita në të cilën është transferuar ankuesi nuk është pozitë e lirë fakt i konfirmuar nga arsyetimi i vendimit të kontestuar dhe ndërlidhur me këtë elementë i njëjti ligj përmes nenit 19 paragrafi 4 në rast të mungesës së drejtorit të departamentit parasheh; "4. Drejtori i departamentit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga udhëheqësi i divizionit, i caktuar me shkrim nga vetë drejtori apo, në rast pamundësie shëndetësore, caktohet me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm", andaj edhe mbi këtë bazë konstatohet se vendimi i kontestuar sipas kësaj ankese nuk është në harmoni me këto dispozita ligjore të përcaktuara si më lartë.

Po ashtu duke ju referuar pretendimit të ankuesit sa i përket informimit para transferimit kolegji konstaton se ka munguar komunikimi respektivisht ankuesi nuk është informuara për këtë proces siç parashihet me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: "1.Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës", kjo rrethanë konfirmohet edhe përmes faktit se ankuesi në kohën e marrjes së vendimit kishte qenë në pushim vjetor kështu që me këtë veprim është shkelur neni 9 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që ka të bëjë me informimin e ankuesit në lidhje me fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm i cili nen specifikisht parasheh "2 Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj", andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.692/2022, datë 21/09/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

